



# UDHËZUES

për prindërit e vetëm



## **UDHËZUES PËR PRINDËRIT E VETËM**

**Botues:**

OJQ Fëmijët e Malit të Zi

[www.djecacrnegore.me](http://www.djecacrnegore.me)

E-mail: [djecacrnegore@yahoo.com](mailto:djecacrnegore@yahoo.com)

***Për botuesin:***

Sabra Deceviq

***Publikimin e përgatitën:***

Nazif Veliqi

Mehmet Duraku

Renata Blenishta

Lirije Buzuku

***Dizajni dhe përgatitja grafike:***

Arben Husiq

***Tirazhi:***

300 kopje

Shtypi: TRIO PRO - Ulqin

Ulqin, 2015

*Ilustrimet e përdorura në këtë broshurë, janë marrë nga faqet publike të internetit (freepik.com & freevector.com) për publikim falas.*

Botimin e këtij publikimi e mbështeti Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij udhëzuesi është përgjegjësi vetëm e OJQ Fëmijët e Malit të Zi dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimin e Bashkimit Evropian.

## DY FJALË PËR PROJEKTIN

“Udhëzuesi për prindërit e vetëm” është hartuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i partneritetit për ofrimin e shërbimit të ri social në Ulqin”, i cili realizohet me mbështetjen e Asociacionit të Agjencive për Demokraci Lokale (ALDA) dhe Agjencisë për Demokraci Lokale – Nikshiq, financuar nga Bashkimi Evropian përmes Delegacionit të BE-së në Mal të Zi.

Projektin “Ndërtimi i partneritetit për ofrimin e shërbimit të ri social në Ulqin” së bashku e realizojnë organizatat e shoqërisë civile “Fëmijët e Malit të Zi” nga Podgorica dhe “Horizonti i Ri” nga Ulqini.

“Udhëzuesi për prindërit e vetëm” është rezultat i punës së përbashkët të Qendrës për punë sociale – Njësia rajonale Ulqin, Komunës së Ulqinit dhe OJQ-ve Fëmijët e Malit të Zi dhe Horizonti i Ri.

## PËRSE U HARTUA KY UDHËZUES DHE KUJT I DEDIKOHET?

Statistikat tregojnë se numri i familjeve që përbëhen nga një prind dhe fëmijët (në Mal të Zi), rritet nga viti në vit. Sipas të dhënave të Qendrës për Punë Sociale në Ulqin, vlerësohet se ka rreth 160 prindër të vetëm, prej të cilëve shumica janë nëna kryefamiljare. Nuk ekziston një bazë e veçantë e të dhënave për prindërit e vetëm në nivel të komunës dhe kjo e vështirëson vlerësimin e nevojave për rastet individuale. Duke pasur parasysh se për këtë problem ka pak punime, analiza dhe veprime konkrete, në komunën e Ulqinit përmes OJQ Horizonti i Ri dhe Qendrës për punë sociale organizohen programe mbështetjeje për prindërit e vetëm që nga viti 2012.

Përmes këtij projekti avancohet dhe zgjerohet bashkëpunimi i institucioneve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile në fushën e shërbimeve sociale.

Rezultat i veçantë i këtij bashkëpunimi është Udhëzuesi për prindërit e vetëm, i cili për herë të parë botohet në Mal të Zi, ashtu sikur edhe Baza e të dhënave për prindërit e vetëm e cila për herë të parë hartohet për komunën e Ulqinit.

Përveç hartimit të këtij udhëzuesi, në kuadër të projektit janë organizuar edhe 5 trajnime për fuqizimin e 20 grave – nëna kryefamiljare; 5 sesione psiko-sociale me 20 fëmijë minorenë; është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me institucionet lokale; është krijuar baza e të dhënave për prindërit e vetëm në komunën e Ulqinit, etj.

\* \* \*

“Udhëzuesi për prindërit e vetëm” ka për qëllim t’ju njoh me të drejtat tuaja:

- në hapat e parë të procesit të divorcit
- obligimet e Qendrës për Punë Sociale
- si punon Ekipi për Martesë dhe Familje
- si vepron Gjykata

## HYRJE

Keni vendosur të ndaheni. Lidhja jote me bashkëshortin nuk ekziston më, por marrëdhënia jote si prind do të ekzistojë përgjithmonë - nga fëmija nuk dëshiron dhe nuk mund të divorcohesh. Je me fat, pasi të dy si prindër jeni te interesuar për fëmijët dhe mund të bini dakord. Mijëra pyetje të shqetësojnë, por më e rëndësishmja ndër të gjitha është: çfarë do të ishte më së miri për fëmijët?

Rezultatet e shumë studimeve tregojnë se fëmijët e prindërve të cilët jetojnë në një martesë harmonike dhe fëmijët e prindërve të divorcuar, kur fëmijët kanë kontakt të rregullt me të dy prindërit, nuk dallojnë për nga arritja shkollore dhe sjellja sociale. Fëmijët nga të dy këto grupe, pavarësisht nëse prindërit janë në martesë apo jo, kanë pasur sukses të mirë në shkollë dhe janë më pak të prirur për sjellje të padëshirueshme dhe të dëmshme. Rezultatet tregojnë se, në qoftë pyeten fëmijët, përveç në rastet e abuzimit të rëndë, fëmijët i duan të dy prindërit.

Rezultatet tregojnë gjithashtu se për nga suksesi në shkollë dhe sjellja sociale, fëmijët e prindërve të cilët janë në një martesë me konflikte të vazhdueshme, nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga fëmijët e prindërve të divorcuar të cilët janë në konflikt të vazhdueshëm. Kjo vlen dhe për rastet kur kontakti me njërin prind është i kufizuar apo kur kontakti prindër-fëmijë është krejtësisht i ndërprerë. Fëmijët nga të dy këto grupe, pavarësisht nëse prindërit janë në martesë apo jo, arrijnë suksese më të dobëta në shkollë dhe janë më të prirur për sjellje të padëshirueshme dhe të dëmshme. Gjendje kjo, që vërehet në rritjen e numrit të delikuencës së të miturve, në abuzimin me droga dhe alkool, si dhe në shtatzënitë e të miturve.

Mund të konsiderohet se vetë divorci nuk është ai që më së shumti i godet fëmijët, por është vetë konflikti i prindërve, pavarësisht nëse prindërit janë në martesë apo jo.

Divorci në jetën tënde sjell shumë ndryshime të cilët nuk janë gjithmonë të lehta për t'u përballuar. Ndoshta je e zemëruar, e ofenduar, thellësisht e bindur se pikërisht ti ke arsyet e vërteta për t'u ndjerë kështu. Shpesh këto ndjenja janë reciproke. Ke të drejtë të ndjehesh kështu, por nuk ke të drejtë që fëmijët të vuajnë pasojat e ndjenjave tuaja negative.

Fëmijët nuk janë përgjegjës për zgjedhjen tënde të bashkëshortit/partnerit, kështu që nuk duhet t'i vuajnë as pasojat. Nëse ke në zemër mirëqenien e fëmijës, do bini dakord për atë se me cilin prind do të jetojë fëmija, për kontaktet si dhe kontributin financiar për mbështetjen e fëmijës. Dhe sigurisht që do t'i përmbaheni kësaj marrëveshje.

Harroje ish-bashkëshortin si partnerin tënd dhe pranoje atë si prindin e fëmijës tënd, sepse ky do të jetë roli i tij përgjithmonë.

## NUK MUND TË BINI DAKORD

Përvojat në të cilat mbështet kjo pjesë e Udhëzuesit, janë përvojat e prindërve të cilët konsiderojnë se nuk iu është ofruar mbështetja e duhur nga institucionet shtetërorë, për të mbrojtur fëmijët tuaj gjatë procesit të divorcit dhe më pas.

Shpesh ndodhë që nuk mund të merreni vesh. Prindi tjetër refuzon, nuk dëshiron të pajtoheni, dëshiron të të fshijë nga jeta e tij dhe e fëmijës; fëmijës i flet për ty gjëra të këqija dhe në çdo mënyrë përpiqet që të prishë raportin tënd me fëmijën. Dëshiron të të dënojë. Nuk e vëren që kjo më së shumti e dëmton fëmijën. Mendon se fëmija do ta dojë më pak atë nëse do të të dojë edhe ty. Nuk di ose harron që fëmija ka një kapacitet të madh dashurie dhe se gjithnjë e më shumë jep dashuri, sa më shumë njerëz të dojë.

Nganjëherë, sjelljet e dëmshme që përmendëm, nuk shfaqen në procesin e divorcit por më pas, kur prindi tjetër gjen partnerin e ri ose kur ti gjen partnerin e ri. Ose, je ti ai prindi tjetër. Prindi që sillet kështu, më të rëndësishme ka rehatinë e vet (të momentit apo të përhershme), se sa interesin e fëmijës. Nëse këtë e bën prindi tjetër, bëj çdo gjë që ta mbrosh fëmijën nga sjellje të tilla.

Në përpjekjen për të realizuar të drejtat e fëmijës dhe tuajat, mund të përballej me gjëra për të cilat nuk të ka shkuar kurrë ndër mend se ekzistojnë, me një botë tjetër, të re dhe paralele. Të duket sikur bota në të cilën je mësuar të mbështetësh dhe në të cilën ke besuar se ekzistojnë lidhjet shkakësore, është rrënuar. Lidhjet shkakësore (lidhjet midis veprimeve të personit dhe pasojave) tashmë janë këputur dhe kërcënohet një kaos i drejtpërdrejtë – çfarëdo lloj shkak mund të sjellë çfarëdo lloj pasoje. Prindërit nuk mund t'ia sqarojnë vetvetes se si një shkak siç është problemi i varësisë (nga drogat) i njërit prind, nuk ka për pasojë rekomandimin dhe vendimin që fëmija duhet të jetojë me prindin që nuk është i përdorues i drogave.



Në qoftë se ndodhë prishja e martesës (aty ku grindjet bashkëshortore janë të trazuara edhe martesa është e paqëndrueshme), si të kërkohen të drejtat dhe të zbatohet vendimi i gjykatës, duke synuar gjithmonë interesin më të mirë të fëmijës. Si të shpjegohet që prindi të cilit me vendim përfundimtar të Gjykatës i janë caktuar fëmijët në përkujdesje dhe është caktuar mbështetja financiare për prindin tjetër, nëse kërkon ndihmën e institucioneve sepse nuk po e merr këtë mbështetje financiare, zyrtarët e këtyre institucioneve i rekomandojnë të bëj padi penale, në vend që të angazhohen për ekzekutimin e vendimit dhe të bëjnë të mundur që prindi të marrë sa më parë kontributet e prapambetura.

Prandaj përmbaju fakteve, argumenteve dhe logjikës së shëndoshë. Mësohu të flasësh me argumente, me përmbajtje, qartë dhe konciz. Mëso gjithashtu që bisedën që e bën (kështu të argumentuar, të strukturuar, të qartë dhe përmbledhëse), në formë të shkruar t'ia paraqesësh institucioneve përkatëse dhe të ruash vërtetimin që e ke dorëzuar shkresën tënde.

Besojmë se fëmija dhe ti keni një të ardhme të shkëlqyer, nëse nuk bëheni armiq të vetvetes.

Kujdesu për shëndetin tënd, punën, kontaktet shoqërore, cilësinë e jetesës – mos i dëshiro fëmijës tënd një prind të thyer, të lodhur e të vetmuar. Përfshihu në ngjarje dhe aktivitete shoqërore, kërko ndihmë profesionale. Bëhu këmbëngulëse dhe e durueshme, të jesh fitimtare në përpjekjen që fëmija yt t'i ketë të dy prindërit – tani dhe në të ardhmen.

Nëse je prind që e dëshiron marrëveshjen dhe ke për qëllim mirëqenien e fëmijës, por marrëveshjen nuk e arrin dot sepse prindi tjetër refuzon, shpresojmë që teksti në vijim të kësaj broshure të të ndihmoj.

E në qoftë se je prind i cili refuzon çdo marrëveshje, duke pritur që institucionet e shtetit të kujdesen për interesin më të mirë të fëmijës tënd, duke iu hedhur përgjegjësinë të tjerëve, ta kesh të ditur se sjellja jote nuk është në interes të fëmijës, sepse marrëveshja e prindërve është më e mirë nga të gjitha zgjidhjet që mund të ofrojnë institucionet. Mos harro që sipas Ligjit për Familjen, prindi është i detyruar të kujdeset për fëmijën e vet. Shpresojmë që ky tekst të të ndihmojë të dallosh se pse ajo që bën (nëse shmang marrëveshjen për fëmijët e përbashkët) nuk është e mirë dhe se do të përpiqesh të ndryshosh qëndrimet dhe sjelljet tuaja në një drejtim pozitiv.

## ÇKA DUHET TË BËSH NË FILLIM DHE ÇKA VIJON MË PAS?

Së pari, **kërko një avokat** (në qoftë se ke mundësi financiare, nëse jo, kërko ndihmë ligjore falas) pasi do të jetë avokati yt ai i cili do të të përfaqësojë dhe do të dorëzojë një ankesë për divorc në Gjykatë, duke marrë parasysh juridiksionin lokal. Thelbi i procedurës për të vendosur përbajtjen e të drejtës prindërore, e që është një proces krejtësisht i ndryshëm nga çdo tjetër, është i tillë që e detyron gjykatën që për interes të fëmijës të hulumtojë dhe të shqyrtojë të gjitha faktet me rëndësi për vendimin, pavarësisht nëse prindi ka një avokat të gatshëm e të motivuar.

Pastaj përcakto qëllimet tuaja dhe renditi sipas rëndësisë. Çfarë ke në vend të parë?

Kujdesi prindëror është i përbashkët edhe pas divorcit. **Prindi i cili nuk jeton me fëmijën, ka të gjitha të drejtat dhe të gjitha përgjegjësitë prindërore edhe pas divorcit.**

Nëse fëmija jeton me ty, menjëherë duhet të bësh të mundur pjesëmarrjen sa më të gjerë të prindit tjetër në edukimin e fëmijës. Përpiqu të sigurosh nga ai pagesën për mbështetjen e fëmijës (alimentacionin). Është e panevojshme dhe e papërgjegjshme të presësh vendimin e gjykatës kur bëhet fjala për të drejtat e fëmijës. Bëj një hap më tej - bini dakord me njëri-tjetrin, duke u kujdesur që çdo gjë të jetë në interesin më të mirë të fëmijëve tuaj.

Nëse ke vendosur të paraqesësh kërkesën për divorc, por këtë hap ende s'e ke bërë nga arsye të ndryshme, ndërsa grindjet bashkëshortore janë të padurueshme dhe nuk mundesh më t'i përballosh sfidat e familjes, atëherë shfrytëzoje të drejtën nga neni 80 (paragrafi 1) i Ligjit për Familje të Malit të Zi, i cili thotë: “**Organi i kujdestarisë është i detyruar që prindërve t’iu ofrojë mbështetje adekuate dhe të ndërmarrë veprimet e duhura për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe interesin më të mirë të fëmijës, në bazë të informacioneve dhe konstatimeve të drejtpërdrejta**”.

Kur tashmë e ke filluar procesin e divorcit, duhet të dish që në interesin më të mirë të fëmijës është të ketë komunikim të rregullt dhe kontakte personale me të dy prindërit. E nëse për këtë nuk arritët të merreni vesh, Gjykata do të kërkojë nga Qendra për Punë Sociale mendimin e ekipit të profesionistëve se kujt duhet t’i besohet përkujdesja e fëmijëve.



**Kërko ndihmë profesionale nga organi i kujdestarisë, pa marrë parasysh mendimin e palës kundërshtarë. Nëse prindi tjetër e refuzon ndihmën profesionale për tejkalimin e konfliktit, nëse refuzon të paguaj mbështetjen financiare (për fëmijët), nëse të pengon që të kalosh kohën me fëmijën, kërko nga Qendra për Punë Sociale të ndërmjetësojnë në zgjidhjen e problemit tënd.**

Pasi të kesh paraqitur kërkesën për divorc sepse martesë juaj është e paqëndrueshme, Gjykata pa vonesë do të të thërras në seancë gjyqësore dhe pastaj do të kryejë procedurën e ndërmjetësimit në përputhje me Ligjin për Ndërmjetësim dhe Ligjin për Familje. Gjykata do të të ofrojë të zgjedhësh nga lista e ndërmjetësuesve (mediatorëve) personin që do të ndërmjetësojë. Në qoftë se nuk mund të merreni vesh për ndërmjetësuesin, Gjykata do të caktojë ndërmjetësuesin me një vendim të posaçëm.

## **ÇKA ËSHTË NDËRMJETËSIMI DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?**

**NDËRMJETËSIMI** ose **MEDIACIONI** është mënyrë e pëlqyeshme dhe e përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve familjare, me ndihmën e një personi të tretë, neutral. Kjo është një procedurë e cila ndihmon në zgjidhjen e problemeve dhe në arritjen e marrëveshjes, e cila do të jetë e favorshme për të dy palët në konflikt. Në këtë procedurë para së gjithash i kushtohet kujdes interesit të fëmijës.

### **KUSH JANË NDËRMJETËSUESIT?**

Juristët, punëtorët social, psikologët, pedagogët, të cilët mund të punojnë edhe si bashkë-ndërmjetësues (në çift) dhe të cilët kanë edukim të veçantë për ndërmjetësim në mosmarrëveshjet familjare.

### **KUSH JANË PJESEMARRËSIT?**

Palët në konflikt, por me ata mund të marrin pjesë edhe avokatët e tyre.

### **CILËT JANË MOSMARRËVESHJET?**

Mosmarrëveshjet se kujt t'i besohen fëmijët, mosmarrëveshja për mbështetjen financiare të fëmijës/ish partnerit, mosmarrëveshjet për ndarjen e pasurisë bashkëshortore, divorci, mosmarrëveshjet për përcaktimin e atësisë, etj.

### **PSE?**

Ndërmjetësimi kryhet shpejt; siguron një kuptim më të qartë të situatës dhe gjetjen e zgjidhjeve të pranueshme për të dy palët; mbanë apo vendosë komunikimin dhe besimin midis palëve të interesuara.

## PARIMET E PROCEDURËS SË NDËRMJETËSIMIT

**PËLQIMI** – nënshkrimi i pëlqimit për pjesëmarrje në procedurën e ndërmjetësimit.  
**VULLNETARISHT** – palët vullnetarisht vendosin të hyjnë në këtë procedurë, ndërsa pëlqimin mund ta tërheqin palët dhe ndërmjetësuesi në çdo fazë të ndërmjetësimit.  
**RUAJTJA E FSHEHTËSISË** – ka të bëjë me të gjithë procedurën, me informatat që shkëmbehen në takimet e përbashkëta ose të ndara, si dhe në raport me publikun.  
**LIGJSHMËRIA** – veprohet në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.  
**PAANSHMËRIA** – ndërmjetësuesi është objektiv, nuk ofron dhe nuk imponon zgjidhje; ai ndihmon në gjetjen e zgjidhjes e cila është e pranueshme për të dy palët.  
**BARAZIA** – palët në procedurë janë njësoj të rëndësishme dhe kanë të njëjtën mundësi pjesëmarrjeje apo përfaqësimi.  
**KOMPETENCA** – ndërmjetësuesit janë persona profesionistë dhe me reputacion, të trajnuar për këtë punë.

Në qoftë se ndërmjetësimi nuk pati sukses dhe ndërmjetësuesi e lajmëron Gjykatën për këtë, Gjykata atëherë thërret seancë dëgjimore me procedurë të përshpejtuar. Kuptimi i fjalës “të përshpejtuar” këtu është krejtësisht relativ pasi kjo mund të jetë pas një muaji ose disa muajve, por ekzistojnë edhe raste kur seancat dëgjimore për masa të përkohshme, thërriten edhe pas gjashtë muajve, kurse për divorc edhe pas një viti.

Në qoftë se je e pakënaqur me vendimin e gjykatës, mund të ankolesh në nivelet më të larta gjyqësore e deri në Gjykatën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Nëse nuk ecën ndryshe, nëse të drejtat e fëmijës dhe të tuat nuk mund t'i realizosh në kuadër të institucioneve shtetërore, është e drejtë e jotja legjitime dhe demokratike t'iu drejtolesh mediave. Në këtë rast të kesh ndërmend që fëmija yt do t'i lexojë deklaratat e tua në media dhe në asnjë mënyrë në deklaratat e tua mos e fyej prindin tjetër, ndërsa identitetin e fëmijës mbroje gjithsesi. **Nuk iu drejtolesh mediave për hakmarrje personale por për shkak të mosfunksionimit të sistemit, prandaj në deklaratat e tua merru vetëm me këtë. Hakmarrja personale, gjithmonë - pra edhe në medie, do t'i shkaktojë një dëm të madh fëmijës tuaj.**

Gjykata poashtu do të kërkojë nga Qendra për Punë Sociale dosjen tënde dhe mendimin për ty si prind. Raporti i Qendrës përfshinë grumbullimin e të dhënave sociale dhe historive mjekësore për të dy prindërit, vështrimin për rrethanat socio-ekonomike të prindërve, trajtimin psikologjik, kontaktet me kopshtin ose shkollën të cilën ndjek fëmija, me mjekët dhe me institucionet tjera, sipas nevojës.

Raportin e përpunon Ekipi për Familje dhe Martesë, të cilin e përbën punëtori social, psikologu, juristi, dhe sipas nevojës, edhe ekspertë të tjerë.

**Qendra për Punë Sociale është e obliguar ta dorëzoi mendimin dhe propozimin e vet sa më shpejt, nga dita e kërkesës së Gjykatës. Raporti i dërgohet Gjykatës në lëndën për divorc e nëse është e hapur edhe procedura për caktimin e masës së përkohshme, raporti dorëzohet edhe në këtë lëndë. Bëhu e fortë, në qoftë se keni mirëkuptim të përbashkët, ushtroni kujdestari të përbashkët. Propozojani këtë Gjykatës.**

Gjatë gjithë procedurës së divorcit, ke të drejt të dish se në cilën fazë ndodhet rasti yt. Se sa është e rëndësishme rrjedha e kësaj procedure, tregon edhe neni 336 i Ligjit për Familje, i cili thotë: ***“Gjatë gjithë procedurës për divorc, gjykata është e obliguar të bashkëpunojë me organet e kujdestarisë dhe shërbimet tjera profesionale të cilat merren me çështjet e martesës dhe të familjes, sidomos kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, të mitur”.***

Në Gjykatë eja e veshur me hije dhe rregull, sillu me respekt ndaj ish bashkëshortit dhe ndaj gjithë zyrtarëve tjerë. Gjithashtu kërko nga të gjithë të të respektojnë edhe ty. Respekti këtu ka të bëjë me ton të qetë, shmangien e fjalëve të rënda, t’iu drejtohesh të pranishmëve në mënyrë të përshtatshme, të dëgjosh me vëmendje. Fakti që gjendesh aty (në Gjykatë), nuk do të thotë që ti je qytetare e rendit të dytë, nuk përcaktohet fajti i dikujt. Deklaratat, pyetjet dhe komentet e palës tjetër dhe avokatit të tij, mos i merr personalisht. Dëgjo me kujdes dhe merru vesh me avokatin tënd se si të reagosh nëse këto janë të pavërteta dhe fyese. Theksoji problemet me argumente dhe arsytetime. Pastaj paraqiti dhe arsyetoi propozimet e tua. Të jesh e gatshme për lëshime, por kurrsesi për lëshime që shkojnë në dëm të fëmijës. Gjithmonë të kesh parasysht parimin themelor të Konventës për të Drejtat e Fëmijës – “Interesi më i mirë i fëmijës”.

E drejta për kontributin financiar (të jetesës), e drejta për familje dhe për të dy prindërit, janë të drejta të fëmijës dhe me ato nuk mund të luhet e të tregtohet.

Kush vjen për fëmijën, ku e merr: në shtëpi, para shtëpisë, në park; çfarë fëmija merr me vete në shtëpinë e prindit tjetër, si do të rrjedh komunikimi midis prindërve – për të gjitha këto ke të drejt të negociosh dhe të bësh lëshime. Mos u merr me vogëlsira, kujto qëllimet që ia ke vënë vetes.



## ÇKA DUHET TË BËJË QENDRA PËR PUNË SOCIALE DHE NË ÇFARË AFATI

Praktika e punës sociale që nga zanafilla ka qenë e fokusuar në përbushjen e nevojave njerëzore dhe në zhvillimin e resurseve njerëzore.

“Puna sociale është profesion që ka për qëllim të sjellë ndryshime shoqërore të përgjithshme në shoqëri dhe në format e saja individuale të zhvillimit” (Federata ndërkombëtare e punëtorëve social, 1982).

Punëtorët social profesionistë janë të angazhuar për t’i shërbyer mirëqenies dhe vetë-përbushjes së qenieve njerëzore; zhvillimit dhe përdorimit të disiplinuar të njohurive shkencore në lidhje me sjelljen njerëzore dhe shoqërore; zhvillimit të resurseve me të cilat do të përbusheshin nevojat dhe dëshirat individuale, grupore, nacionale dhe ndërkombëtare; dhe janë të angazhuar në arritjen e drejtësisë sociale.

Qendra për Punë Sociale nuk ka kompetenca të sjellë vendime, ku dhe me cilin prind do të jetojë fëmija, as për kohën që fëmija do të kalojë me prindin tjetër. **Këtë mund ta bëj vetëm Gjykata.**

Këtu duhet të theksojmë se në të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me fëmijët e mitur, Gjykata kërkon mendimin dhe propozimin e Qendrës, të cilët për Gjykatën nuk janë obligues, por është e obliguar që gjatë gjithë procesit të bashkëpunojë me këtë institucion.



Në qoftë se:

- ☞ marrëdhëniet tuaja janë prishur marrëzisht (në qoftë se ka dhunë të çfarëdo forme) pra, nëse ish partneri yt ose familja e tij të **sulmojnë fizikisht** ose gojarisht **apo sulmojnë fëmijën**, thirr Policinë (122), lajmëro Qendrën për Punë Sociale (030 412 205) ose kontakto SOS Telefonin për gra dhe fëmijë viktime të dhunës (030 411 700). Nëse këtë e bën prindi më të cilin fëmija jeton apo familja e tij, mund të kërkosh nga Gjykata të ndryshojë vendimin se me cilin prind do të jetojë fëmija. Në qoftë se këtë e bën prindi me të cilin fëmija nuk jeton dhe familja e tij, mund të kërkosh ndryshimin e vendimit për takime dhe kontakte.
- ☞ bashkëshortët jetojnë së bashku por njëri prind **nuk kujdeset për shëndetin e fëmijës**, nënkuptohet që këtë do ta bëjë prindi tjetër. Në qoftë se bashkëshortët nuk jetojnë së bashku, ndërsa fëmijën e lë pas dore prindi me të cilin fëmija jeton, prindi tjetër për këtë duhet të njoftoi (në formë të shkruar) Qendrën për Punë Sociale dhe të kërkojë reagimin e saj.
- ☞ bashkëshorti të **ka nxjerr jashtë nga shtëpia e përbashkët dhe ka mbajtur fëmijën**, lajmëro Policinë (si çdo dhunë tjetër në familje) dhe kërkoi ndërhyrjen e menjëhershme të Policisë.
- ☞ bashkëshortët jetojnë së bashku, në rastin kur **njëri prind me sjelljen e tij** (p.sh. është përdorues i drogave dhe alkoolit) rrezikon fëmijën, prindi tjetër është i detyruar ta mbrojë fëmijën ose do të konsiderohet që të dy prindërit kanë lënë pas dore fëmijën. Në qoftë se bashkëshortët nuk jetojnë së bashku ndërsa përdorues i narkotikëve është prindi me të cilin fëmija nuk jeton, prindi me të cilin fëmija jeton mund të kërkojë takime dhe kontakte nën mbikëqyrje ose ndalimin e kontakteve. Në qoftë se përdorues i narkotikëve është prindi me të cilin fëmija jeton, prindi tjetër duhet të kërkojë ndryshimin urgjent të vendimit të Gjykatës, e deri sa të ndryshojë vendimi, të kërkojë edhe mbikëqyrjen e Qendrën për Punë Sociale.



## EKIPI I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE KRITERET PËR VLERËSIMIN E “INTERESIT MË TË MIRË TË FËMIJËS”

**Ekipi për çështjet familjare** – punëtori social, psikologu dhe juristi, i japin mendimin Gjykatës në të gjithë proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet familjare nga kompetencat e gjykatës: *me cilin prind do të jetojë fëmija, kohën që do të kalojë me prindin tjetër, mjetet për jetesë, dhënia në përkujdesje dhe edukim jashtë familjes e të ngjashme*. Ekipi jep mendimin e vet në bazë të të dhënave për rritjen e fëmijës dhe marrëdhënieve me familjen e parë, edukimin, përvojën e punës së prindërve, kushtet e banimit dhe të ardhurat e tyre, kryerjen e obligimeve prindërore, etj. Pra ky ekip hulumton rrethanat ekonomike, banesore, afariste, shëndetësore por edhe rrethanat tjera të prindërve.

**Punëtori social** (me propozim të njërit apo të të dy bashkëshortëve ose të ndonjë personi të tretë siç është kopshti, shkolla, etj.) merr të dhënat sociale dhe historitë mjekësore të familjes, participon në forma të ndryshme të ndërhyrjeve në marrëdhëniet familjare (viziton familjen, shkollën, kopshtin), thërret prindërit në bisedime dhe merr pjesë në bisedimet e bashkëshortëve.

**Psikologu** – jep mendimin në bazë të konstatimeve që nxjerr nga teknikat psikologjike, bisedat me fëmijën, informacionet nga kopshti ose shkolla, apo duke shfrytëzuar instrumentet psikologjike: testimet dhe intervistat me të cilat vlerësohet ngrohtësia emocionale, marrëdhëniet e besimit, krijimi i ndjenjës së sigurisë, përfshirja në përbushjen e nevojave të përgjithshme të fëmijës, sistemi i vlerave.

**Juristi** – informon bashkëshortët për pasojat ligjore të divorcit dhe për të drejtat prindërore, d.m.th. për detyrimet e tyre.

Në rastin ideal, njëri apo të gjithë anëtarët e këtij ekipi posedojnë edukim të veçantë për nevojat dhe interesin më të mirë të fëmijës.

Kur flitet për “interesin më të mirë të fëmijës” nuk ka një interpretim apo protokoll unik. *Pasi merret vendimi nga organi i kujdestarisë (Qendra Për Punë Sociale), Gjykata zakonisht e pranon mendimin dhe propozimin e tyre. Gjykata mund të kërkojë ekspertizë shtesë, nëse e vlerëson që kjo është e domosdoshme.*

Duke pasur parasysh se mendimi kryesisht jepet që kujdestaria t'i takojë njërit prind, lind pyetja çfarë ndodhë me fëmijën dhe prindërit nëse fëmija i do të dy prindërit dhe është i dhënë pas të dyve në mënyrën e vet!? Në qoftë se të dy prindërit janë të aftë për kryerjen e të drejtave prindërore dhe nuk ekzistojnë pengesa për ushtrimin e këtyre të drejtave, ka zgjidhje – e kjo është kujdestaria përbashkët.

Është me rëndësi të theksohet se: fëmija që ka mbushur 15 vjeç, ka të drejt të deklarohet se me cilin prind do të jetojë; fëmija që ka mbushur 10 vjeç mund të shpreh dëshirën se me cilin prind do të jetojë.

Pra, në çdo moment gjatë gjithë procesit të divorcit, qoftë ky “raporti i rregullt” apo ekspertiza të cilën e ka urdhëruar Gjykata, parimi themelorë dhe më i rëndësishëm është respektimi i të drejtës së fëmijës.

Për interesin më të mirë të fëmijës mund të lexosh edhe në KONVENTËN PËR TË DREJTAT E FËMIJËS. Mali i Zi është nënshkruar i kësaj konvente që nga viti 2006 dhe është i detyruar t'i përmbahet Konventës, të hartojë ligje dhe t'i zbatoj ata duke bërë të mundur që të gjithë institucionet dhe qytetarët t'i përmbahen Konventës.

### KUSH DUHET TË JETË PREZENT NË BISEDËN (INTERVISTËN) QË ZYRTARËT E QENDRËS PËR PUNË SOCIALE ZHVILLOJNË ME FËMIJËN

Në qoftë se zyrtarët e Qendrës bisedojnë me fëmijën, është praktike që këtë ta bëjnë pa prezencën e prindërve, por nganjëherë mund t'i inkuadrojnë edhe prindërit dhe të vëzhgojnë bashkëveprimet me fëmijën. Për nevojën e kësaj bisede, vendin dhe kohën, më parë merren vesh me prindërit. Konsiderojmë se kur të merreni vesh me zyrtarët e Qendrës, gjithmonë (e sidomos nëse fëmija është në moshën parashkollore), duhet të insistoni që të dy prindërit të jenë prezent në çdo bisedë të fëmijës tuaj me çdo person të panjohur, e kjo përfshinë edhe profesionistët e Qendrës për Punë Sociale. Vetëm në rast të hetimit kriminalistik mund të jetë e domosdoshme që eksperti të flasë me fëmijën pa praninë e prindërve. Për fëmijën e kësaj moshe është shumë stresuese që të lihet vetëm me një person të panjohur dhe këtë zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale duhet ta marrin në konsideratë.

## A ZBATON QENDRA PËR PUNË SOCIALE TRAJTIM TË BARABARTË PËR TË DY PRINDËRIT?

Nuk ka bazë ligjore për trajtim të ndryshëm ndaj prindërve. Në Qendër punojnë njerëz. E njerëzit, pavarësisht nga deklaratat, konventat ose ligjet, janë të prirur për paragjykimet. Ti duhet të insistosh në respektimin e ligjit dhe mos lejo shkeljen e tij. Paragjykimet ndaj njërit prind detyrimisht shkaktajnë shkeljen e të drejtave të fëmijës, duke favorizuar njërin prind e jo fëmijën. Këshillohu me avokatin se si mund të mbrohesh nga diskriminimi.

Ligji nuk parasheh që prindërit, në bazë të gjinisë, të kenë të drejta të ndryshme që fëmija të jetojë me ata pas divorcit. Në bazë të informacioneve nga shumë prindër, në realitet kjo mund të ndodhë ndryshe. Prandaj mos i përdor paragjykimet gjinore që ekzistojnë edhe nëse je:

- ☞ nëna – lufto me paragjykimet dhe frikën tënde sa më parë. Mos lejo që paragjykimet të të pengojnë në përpjekjen tënde të vazhdueshme që fëmija t'i ketë të dy prindërit. Fëmija yt nuk meriton asgjë më pak;
- ☞ babai – duhesh sa më parë t'i luftosh paragjykimet e shumta, duke përfshirë edhe paragjykimet dhe frikën për aftësitë e tuja prindërore. Mos lejo që paragjykimet të të pengojnë në përpjekjen tënde të vazhdueshme që fëmija t'i ketë të dy prindërit. Fëmija yt nuk meriton asgjë më pak.

## ARSYETIMI I REKOMANDIMIT TË CILIN QENDRA PËR PUNË SOCIALE IA DËRGON GJYKATËS

Në rekomandim dhe në arsyetimin e tij, të cilin Qendra ia dërgon Gjykatës, duhet që në mënyrë objektive të tregohen përparësitë dhe mangësitë e secilit prind; informacionet që merren nga fëmija si dhe mendimi dhe propozimi i argumentuar se me cilin prind duhet të jetojë fëmija, si dhe ku duhet të bëhen takimet dhe shoqërimet me prindin tjetër.



## SI VEPROJNË ZYRTARËT E QENDRËS PËR PUNË SOCIALE DHE SI TË VLERËSOJMË ANGAZHIMIN E TYRE

Deri tash kemi shkruar se çka punon Qendra për Punë Sociale dhe cilat janë detyrimet dhe përgjegjësitë e saj. Në disa Qendra zyrtarët angazhohen së tepërmi që gjatë procesit të divorcit dhe më pas, ta mbrojnë fëmijën, edhe përkundër rrethanave të vështira në punën e tyre.

Konstatimi që ndonjë sjellje e zyrtarëve shtetërorë është në interesin më të mirë të fëmijës, nuk ka vlerë nëse me atë veprim nuk është e kënaqur familja ose gjysma e familjes. Është e pamundur të punohet në interesin e fëmijës duke lënë pas dore interesin e të gjithë anëtarëve dhe duke mos ruajtur në çdo mënyrë familjen e fëmijës, e cila është një prej parakushteve themelore për mirëqenien e fëmijës.

Askund në botë institucionet nuk e kryejnë punën vetvetiu, por për shkak të insistimit dhe kërkesave të forcave demokratike, organizatave, shoqatave, individëve dhe opinionit publik ne shoqëri.

Nëse ekipi i Qendrës për Punë Sociale e trajton fëmijën tuaj në mënyrë të mirëfilltë, me motivim, në kohën e duhur, në mënyrë profesionale dhe me mirësjellje, por edhe familjen e fëmijës, tregojtu atyre se sa e respekton mundin dhe përpjekjet e tyre. Shkruajtu këtë në një letër në mënyrë që reagimin tënd të mund ta shfrytëzojnë për vetë-vlerësim. Besojmë që shembujt e zyrtarëve të Ekipit për Familje dhe Martesë (të Qendrës për Punë Sociale), të cilët punën e tyre të rënd e të ndershme e kryejnë në kënaqësinë e shfrytëzuesve të shërbimeve sociale, mund t'iu shërbejnë të tjerëve si shembuj të përvojës së mirë. Le të angazhohemi të gjithë që këto shembuj të jenë të shpeshtë dhe të dukshëm.



## ÇKA DUHET TË BËJË GJYKATA DHE NË ÇFARË AFATI

Gjykata para së gjithash ka të drejtën dhe detyrimin që t'i përmbahet Kushtetutës dhe legjislacionit të Malit të Zi.

Gjykata merr vendim në një kërkesë për divorc në procedurën e ekzekutimit për dhënien e masës së përkohshme, në mënyrë që të sigurojë alimentacionin për njërin bashkëshort, kështu që do të ndiqni dy procese gjyqësore njëkohësisht.

Në vendimin e gjykatës për divorc duhet të figurojë edhe vendimi për besimin e fëmijës për përkujdesje dhe edukim, vlera e kompensimit për mbështetjen e fëmijës si dhe mënyra e kontaktimit dhe shoqërimit me prindin me të cilin fëmija nuk jeton. Gjykata ka mundësinë dhe obligimin që të kontrollojë çdo marrëveshje të prindërve dhe nuk është e detyruar të respektojë marrëveshjen e prindërve, që është krejt e logjikshme, sepse prindërit teorikisht mund të merren vesh edhe kundër interesit të fëmijës. Gjykata poashtu ka për detyrë të kontrollojë çdo mendim dhe rekomandim të dorëzuar nga Qendra për Punë Sociale apo ekspertit dhe është përgjegjëse për vendimin pa marr parasysh mendimin e tyre, që do të thotë mund ose jo ta pranojë.

Me vendimin për mosmarrëveshjen martesore, Gjykata mund të vendosë për kufizimin apo heqjen e të drejtës prindërore. Në qoftë se prindi, të cilit (me vendim Gjykate) nuk i është besuar fëmija në përkujdesje dhe edukim, refuzon që vullnetarisht t'ia dorëzojë fëmijën prindit tjetër, vendimi i Gjykatës ekzekutohet forcërisht dhe ky ekzekutim është kompetencë ekskluzive e Gjykatës.

Nëse prindi i cili ka obligimin ligjor të përkujdesjes (financiare) ndaj fëmijës, këtë obligim nuk e kryen rregullisht ose nuk e kryen aspak, mund të përgjigjet në procedurë penale për veprën penale “nuk siguron përkujdesin e fëmijës” e cila është e përshkruar nga Kodi Penal i Malit të Zi.




## ÇKA ËSHTË PARAGJYKIMI GJINOR DHE PSE DUHET TË HIQET?

Kjo është një sjellje ose vendimmarrje e cila bazohet në:

- 1) qëndrimet paragjyquese për natyrën dhe rolet e ndryshme të burrit dhe gruas;
- 2) perceptimet e vlerave të tyre relative; ose
- 3) mitet dhe konceptet e gabuara në lidhje me realitetin shoqërorë dhe ekonomik me të cilin gratë dhe burrat përballen.

Ekzistojnë së paku dy arsye pse duhet hequr paragjykimet gjinore:

1. Ashtu duhet të jetë, sepse salla e gjykatës e çliruar nga paragjykimet gjinore:
  - forcon respektin ndaj gjykatës dhe ndaj ligjit,
  - inkurajon respektin për barazinë gjinore dhe barazinë në përgjithësi
  - promovon respektin e pjesëmarrësve ndaj njëri-tjetrit e që sjell respekt më të madh në sallën e gjykatës
2. Kjo është ligj.



## NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Apelojmë tek prindërit që të bien dakord në interes të fëmijës. Nëse kjo nuk është e mundur, i ftojme ata që të mos heqin dorë nga lufta për të drejtat e tyre dhe të fëmijës. Kjo është detyrë e tyre dhe e drejta e tyre.

Ftojmë të gjithë ata që janë të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve gjatë dhe pas divorcit të prindërve, që së pari të mendojnë për fëmijët sepse fëmijët kanë të drejt për prindërit e tyre dhe familjen e tyre të gjerë.

I ftojme pastaj që të mendojnë për prindërit e fëmijëve dhe të dy familjet e tyre, sepse fëmijët kanë nevojë për ata dhe për shkak se edhe ata kanë të drejtë të jenë me fëmijët e tyre dhe me ata të krijojnë marrëdhënie dashurie dhe përkushtimi.

I ftojme ata që të jenë modestë në përputhje me kompleksitetin e problemit dhe njohuritë e tyre reale, që vazhdimisht të edukohen dhe të hulumtojnë të gjitha mënyrat më të mira të veprimit, të kenë ndershmëri, drejtësi dhe mirësjellje.

Kjo para së gjithash do të thotë se kur prindërit nuk mund të bien dakord për gjatësinë e kohës që secili do të kalojë me fëmijën, asnjë propozim, mendim dhe vendim nuk duhet të jetë kufizues. Përkundrazi, të gjitha propozimet, mendimet dhe vendimet duhet të specifikojnë kohën maksimale me fëmijën të secilit prind.

E kjo do të thotë, kur drejtësisht përcaktohet shuma për mbështetjen financiare të fëmijës (në bazë të pagës neto, pa taksë dhe mbitaksë) dhe prindi nuk e paguan, duhet të ekzistojnë mekanizmat e pagesës, të tillë që do ta rrisin këtë shumë në rast të shmangies ose të vonesës.

Kur ka një vullnet për të bërë diçka, ka edhe një mënyrë për të bërë atë. Është e vështirë, por jo e pamundur.





**Ulqin , 2015**